



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 490/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “M.C Catering” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF- 65963-07-20-2020, me objekt për Lotin II “*Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij*”, me fond limit 27.101.138 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

**Ankimues:** “Delta Doni” sh.p.k.  
Gorre, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara  
Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.07.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-65961-07-20-2020, me objekt për Lotin 1 “*Blerje bukë gruri dhe simite*”, me fond limit 9.711.849 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 13.08.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike përkatësisht (pa TVSH):

- |                           |                               |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. “M.C Catering” sh.p.k. | 21.713.870 lekë, kualifikuar  |
| 2. “Delta Doni” sh.p.k.   | 22.780.580 lekë, kualifikuar  |
| 3. “Nika” sh.p.k.         | 23.896.820 lekë, skualifikuar |
| 4. “Nelsa” sh.p.k.        | 24.496.530 lekë, skualifikuar |
| 5. “4 S” sh.p.k.          | 26.967.050 lekë, skualifikuar |

II.3. Në datën 27.08.2020 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 03.09.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “M.C Catering” sh.p.k. duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon (referuar ankesës së paraqitur prej ankimuesit si të depozituar pranë autoritetit kontraktor, bashkëngjitur ankesës së depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik), dy pretendimet e tjera janë si më poshtë :

[...]

*Sipas vlerësimit të autoritetit kontraktor oferta e shoqërisë sonë është pranuar dhe është renditur e dyta duke plotësuar në këtë mënyrë të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në lidhje me operatorin M.C Catering i renditur i pari kemi dyshime se nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST të cilat janë të detyrueshme dhe nuk duhet bërë tolerime në përmbushjen e tyre. Mendojmë se gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga M. C Catering komisioni i vlerësimit të ofertave mund të mos ketë qenë i vëmendshëm në shqyrtimin e pikave të mëposhtme:*

- 1. Rezultatet e paraqitura në Raport/ fletë analiza fiziko – kimike dhe Raport /Fletë analiza mikrobiologjike nuk janë sipas normave të kërkuara dhe të përcaktuara në ligj.*
- 2. Mendojmë se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për dy automjetet ATV (Frigorifer), pasi automjetet e paraqitura shfaqen në QKR-në e operatorëve të tjerë ekonomikë.*
- 3. Mendojmë se shoferët e paraqitur nuk figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik.*
- 4. Mendojmë se nuk plotësohet periudha tre mujore e stafit prej katër personave të deklaruar. Bazuar në nenin 63, pika 1, pika 2 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se [...].*

*Sa më sipër kërkojmë”*

- 1. Pranimin e ankesës*
- 2. Pezullimin e procedurës së prokurimit*
- 3. Riverifikimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga operatori M.C Catering dhe shqyrtimin me seriozitet të tyre.*

Referuar formularit të ankesës që operatori ekonomik ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor, të cilin, autoriteti kontraktor e ka depozituar me informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 07.10.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 1964/1 prot., datë 05.10.2020, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për Lotin 2 “Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij” për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimorë”, e ndarë në 7 lote”, operatori ekonomik ankimues ka ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

*Mendojmë se gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga M. C Catering komisioni i vlerësimit të ofertave mund të mos ketë qenë i vëmendshëm në shqyrtimin e pikave të mëposhtme:*

- 1. Rezultatet e paraqitura në Raport/ fletë analiza fiziko – kimike dhe Raport /Fletë analiza mikrobiologjike nuk janë sipas normave të kërkuara dhe të përcaktuara në ligj.*

2. *Mendojmë se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për dy automjetet ATV (Frigorifer), pasi automjetet e paraqitura shfaqen në QKR-në e operatorëve të tjerë ekonomikë.*
3. *Mendojmë se kodi i shoferave nuk përputhet me sigurimet shoqërore të operatorit ekonomik MC Catering”*
4. *Mendojmë se dokumentacioni i dorëzuar për pikën e shërbimeve të ngjashme nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e procedurës në fjalë.*

*Bazuar në nenin 63, pika 1, pika 2 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se [...].*

*Sa më sipër kërkojmë”*

1. *Pranimin e ankesës*
2. *Pezullimin e procedurës së prokurimit*
3. *Riverifikimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga operatori M.C Catering dhe shqyrtimin me seriozitet të tyre.*

II.5. Operatori ekonomik sqaron se në datën 11.09.2020, është njohur 1754/3, datë 09.09.2020 të autoritetit kontraktor, i cili i ka kthyer përgjigje duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se:

*[...]*

*Së pari, lidhur me pretendimin: “1. Rezultatet të paraqitura në Raport/Fletë analizo fizike dhe Raport / fletë Analiza Mikrobiologjike nuk janë sipas normave të kërkuara dhe të përcaktuara në ligj”, ju bëjmë me dije se:*

*Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në seksionin 2.3. “Kapaciteti teknik”, në pikën 7 të përcaktohet se operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Raport /fletë analizë Fiziok – kimike, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, jo më herët se 30 ditë nga data e zhvillimit të procedurës për artikujt djathë i bardhë gjysëm i fortë Lope, cilësi e parë, gjalp me kripë Lope, cilësi e parë, qumësht pa yndyrë i sterilizuar, kos, cilësi e parë, 3.5% yndyrë.*

*Nga verifikimi i sistemit të prokurimit publik elektronik rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar ofertuesi “M.C. Catering” sh.p.k. ka dorëzuar dokumentat me emërtimin “MC\_Analizat\_Bulmeti”. Në dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se analizat janë kryer për të gjithë artikujt e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pra për djathë i bardhë gjysëm i fortë Lope, cilësi e parë, gjalp me kripë Lope, cilësi e parë, qumësht pa yndyrë i sterilizuar, kos, cilësi e parë, 3.5% yndyrë si dhe janë në përputhje me specifikimet teknike.*

*Së dyti lidhur me pretendimin: “2. Mendojmë se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për dy automjetet ATV (frigorifer) pasi automjetet e paraqitura shfaqen në QKR-në e operatorëve të tjerë ekonomikë”, ju bëjmë me dije se:*

*Në dokumentat e tenderit në Shtojcën nr. 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në seksionin 2.3 “Kapaciteti teknik” në pikën 3 përcaktohet se:*

*“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë të paktën 2 (dy) automjete të përshtatshme ATV (frigorifer) me qëllim transportin e mallrave të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qera dhe për të cilët duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

- a) *Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qira:*
  - *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
    - *Çertifikata e pronësisë lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj/kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
    - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira”*
      - *Kontratë qiraje*
- b) *Leje qarkullimi e mjetit;*
- c) *Çertifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;*
- d) *Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;*
- e) *Çertifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);*
- f) *Akt miratimi higjeno sanitar;*
- g) *Leje drejtimi automjeti, për të paktën 2 (dy) prej punonjësve”.*

*Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar ofertuesi “MC Catering” sh.p.k. ka dorëzuar dokumentacion për katër automjete ATV. Në dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se ofertuesi për mjetet e paraqitura ka dorëzuar kontratë qiraje, leje qarkullimi, çertifikatën e kontrollit teknik të mjeteve, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikatë për transport mallrash, akt miratimi higjeno – sanitar dhe leje drejtimi automjeti.*

*Së treti, lidhur me pretendimin: “3. Mendojmë se kodi i shoferave nuk përputhet me sigurimet shoqërore të operatorit ekonomik MC Catering”, ju bëjmë me dije se:*

*Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në seksionin 2.3. “Kapaciteti teknik” në pikën 2, përcaktohet: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar për periudhën 3 mujore Prill 2020 – Qershor 2020, një staf punonjësish prej minimalisht 4 (katër) persona. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë: a) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore; b) Listëpagesat e deklaruar në organet tatimore për periudhën Prill 2020-Qershor 2020”.*

*Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar ofertuesi “MC Catering” sh.p.k. ka dorëzuar dokumentet me emërtimin “MC\_Listëpagesa\_Qershor\_2020”.*

*Në dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se drejtuesit e mjeteve mbajnë kodin 8322.01 i cili referuar VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” i ndryshuar, i përket profesionit “Shofer”.*

*Së katërtri, lidhur me pretendimin: “4. Mendojmë se dokumentacioni i dorëzuar për pikën e shërbimeve të ngjashme nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e procedurës në fjalë”, ju bëjmë me dije se:*

*Në dokumentat e tenderit në Shtojcën nr. 9, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, në seksionin 2.3. “Kapaciteti teknik” në pikën 1, përcaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës në vlerën prej të paktën 40% të vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër të këtij Loti. Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Nga verifikimi i sistemit të prokurimit elektronik rezulton se në përmbushje të kriterit të sipërcituar ofertuesi ka dorëzuar dokumentet me emërtimin:*

*“MC\_Kontrata\_Qezhef\_2019\_marrëveshja”,  
“MC\_Ushqime\_QEZHEF\_2018\_1”,  
“MC\_Kontrata\_Qezhef\_2019\_shtesat”,  
“MC\_Ushqimet\_Qezhef\_2018\_2”,  
“MC\_Ushqime\_Qezhef\_2018\_2\_1”,  
“MC\_Furnizim\_B\_Krujë\_2”,  
“MC\_Fatura\_Furnizimi\_Klientë\_Privat\_Bulmet”,  
“MC\_Furnizim\_B\_Krujë\_1”,  
“MC\_Furnizim\_Spitali\_Krujë\_2”,  
“MC\_Furnizim\_Spitali\_Krujë\_1”,  
“MC\_B\_Krujë\_3”.*

*Në dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës janë në vlerën prej të paktën 40% të vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër.*

*Përsa më sipër pretendimi i ofertuesit “Delta Doni” sh.p.k. nuk pranohet.*

II.6. Në datën 21.09.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k., duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë AK (referuar ankesës së dorëzuar në autoritetin kontraktor, të cilën operatori ekonomik ankimues e ka paraqitur bashkëlidhur ankesës së dorëzuar pranë KPP-së).

Konkretisht ankimuesi pretendon:

[...]

*Sipas vlerësimit të autoritetit kontraktor oferta e shoqërisë sonë është pranuar dhe është renditur e dyta duke plotësuar në këtë mënyrë të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

Në lidhje me operatorin M.C Catering i renditur i pari kemi dyshime se nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST të cilat janë të detyrueshme dhe nuk duhet bërë tolerime në përmbushjen e tyre. Mendojmë se gjatë vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga M. C Catering komisioni i vlerësimit të ofertave mund të mos ketë qenë i vëmendshëm në shqyrtimin e pikave të mëposhtme:

1. Rezultatet e paraqitura në Raport/ fletë analiza fiziko – kimike dhe Raport /Fletë analiza mikrobiologjike nuk janë sipas normave të kërkuara dhe të përcaktuara në ligj.
2. Mendojmë se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për dy automjetet ATV (Frigorifer), pasi automjetet e paraqitura shfaqen në QKR-në e operatorëve të tjerë ekonomikë.
3. Mendojmë se shoferët e paraqitur nuk figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik.
4. Mendojmë se nuk plotësohet periudha tre mujore e stafit prej katër personave të deklaruar[...].

II.7. Në datën 07.10.2020, nëpërmjet shkresës me nr. 1964/1 prot., datë 05.10.2020, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për Lotin 2 “Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij” për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimorë”, e ndarë në 7 lote”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “Operatori ekonomik MC Catering sh.p.k., rezultatet e paraqitura në Raport/ fletë analiza fiziko – kimike dhe Raport /Fletë analiza mikrobiologjike nuk janë sipas normave të kërkuara dhe të përcaktuara në ligj”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, Loti 2, Kapaciteti teknik, pika 7, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **Raport/ Fletë Analizë Fiziko-Kimike dhe Raport/ Fletë Analizë Mikrobiologjike**, lëshuar nga një laborator i referencës ose i akredituar sipas legjislacionit në fuqi, jo më herët se 30 ditë nga data e zhvillimit të procedurës, për artikujt:

- Djathë i bardhë gjysmë i fortë Lope, cilësi e pare;
- Gjalp me kripë Lope, cilësi e pare;
- Qumësht pa yndyrë i sterizuar;
- Kos, cilësi e parë, 3.5% yndyrë “.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumentacioni me emërtimin “MC Analizat Bulmeti”,

ku konstatohet se është paraqitur dokumenti fletë analizë e lëshuar nga një laborator i kësaj fushe, për produktet e kërkuara në dokumentat e tenderit dhe konkretisht për djashhtë të bardhë, gjalp me kripë lope, qumësht pa yndyrë, kos.

Sqarojmë se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k., ashtu siç edhe autoriteti kontraktor sqaron në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, në këtë dokument të lëshuar brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, janë paraqitur analizat për produktet e kërkuara për *Djathë i bardhë gjysmë i fortë Lope, cilësi e pare; Gjalp me kripë Lope, cilësi e pare; Qumësht pa yndyrë i sterilizuar; Kos, cilësi e parë, 3.5% yndyrë*, për të cilat janë analizuar dhe janë dhënë elementët sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi objekt shqyrtimi.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet teknike, organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, nga verifikimi i kryer i dokumentacionit të operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k., konstatohet që, ky i fundit, plotëson kriterin e kërkuar në dokumentat e tenderit pasi ka paraqitur raport analizën për produktet djathë, gjalp, qumësht, kos, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.6. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi në rastin konkret nuk është paraqitur dokumenti raport analizë sipas kriterit të përcaktuar në shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, si edhe sipas specifikimeve teknike.

III.1.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.



Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme..

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “*Operatori ekonomik MC Catering sh.p.k., mendojmë se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur për dy automjetet ATV (Frigorifer), pasi automjetet e paraqitura shfaqen në QKR-në e operatorëve të tjerë ekonomikë*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9, Loti 2, Kapaciteti teknik, pika 3, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: “*Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) automjete të përshtatshme ATV (frigorifer), me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira, dhe për të cilët duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*

**a) Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:**

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

**b) Leje qarkullimi e mjetit;**

**c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;**

**d) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;**

**e) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);**

**f) Akt miratimi higjieno – sanitar;**

**g) Leje drejtimi automjeti, për të paktën 2 (dy) prej punonjësve “.**

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton se, në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumentacioni si më poshtë :

1. Kontratë qeraje me nr. 1754 rep, nr. 510 kol, datë 10.10.2019, e lidhur ndërmjet z. I.D. në cilësinë e qeradhënësit dhe “MC Catering” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, me objekt “Dhënie me qera e një mjeti shoqërisë “MC Catering” sh.p.k., lloji ATV, targa AA 394 RE”.

- Çertifikatë e pronësisë së mjetit rrugor

- Leje qarkullimi e mjetit (kapacitet më pak se 1.5 ton)

- Akt miratimi higjieno sanitar datë 22.12.2017 për mjetin me targë AA 394 RE

- Çertifikatë e kontrollit teknik e vlefshme

- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit, e vlefshme

- Taksa vjetore e mjeteve për vitin 2020
  - Ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “MC Catering” sh.p.k.
  - Kartë identiteti z. I.D.
  - Kartë identiteti z. G.P.
  - Foto e mjetit
  - Çertifikatë regjistrimi
2. Kontratë qeraje me nr. 482 rep, nr. 101 kol, datë 01.04.2020, e lidhur ndërmjet z. I.D. në cilësinë e qeradhënësit dhe “MC Catering” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, me objekt “Dhënie me qera e një mjeti shoqërisë “MC Catering” sh.p.k., lloji ATV, targa AA 112 FS”.
- Leje qarkullimi e mjetit (kapacitet më pak se 1.5 ton)
  - Çertifikatë e pronësisë së mjetit rrugor
  - Akt miratimi higjieno sanitar datë 11.3.2013 për mjetin me targë AA 112 FS
  - Kartë identiteti z. I.D.
  - Taksa vjetore e mjeteve për vitin 2020
  - Çertifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
  - Ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “MC Catering” sh.p.k.
  - Ekstrakt i regjistrimit tregtar për subjektin I.Darsi
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit, e vlefshme
3. Kontratë qeraje me nr. 1087 rep, nr. 299 kol, datë 07.08.2020, e lidhur ndërmjet shoqërisë “Soal” sh.p.k. në cilësinë e qeradhënësit dhe “MC Catering” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, me objekt “Dhënie me qera e një mjeti të llojit ATV në pronësi të qeradhënësit, targa AA 845 DS.
- Çertifikatë e pronësisë së mjetit rrugor
  - Leje qarkullimi e mjetit (kapacitet më pak se 1.5 ton)
  - Akt miratimi higjieno sanitar datë 16.08.2012 për mjetin me targë AA 845 DS
  - Ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “ MC Catering ” sh.p.k.
  - Ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “Soal” sh.p.k.
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit, e vlefshme
  - Çertifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
4. Kontratë qeraje me nr. 1708 rep, nr. 492 kol, datë 04.10.2019, e lidhur ndërmjet z. S. P. në cilësinë e qeradhënësit dhe “MC Catering” sh.p.k. në cilësinë e qeramarrësit, me objekt “Dhënie me qera e një mjeti shoqërisë “ MC Catering ” sh.p.k., lloji ATV, targa AA 201 KA.
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “ MC Catering ” sh.p.k.
  - Leje qarkullimi e mjetit (kapacitet më pak se 1.5 ton)
  - Akt miratimi higjieno sanitar datë 23.01.2015 për mjetin me targë AA 201 KA
  - Çertifikatë e pronësisë së mjetit rrugor
  - Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit
  - Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit, e vlefshme
  - Çertifikatë e kontrollit teknik e vlefshme

5. Kontratë huapërdorje me nr. 1086 rep, nr. 298 kol, datë 07.08.2020, e lidhur ndërmjet z. I.D. në cilësinë e huadhënësit dhe “MC Catering” sh.p.k. në cilësinë e huamarrësit, për dhënie në përdorim të një magazine frigoriferike me sipërfaqe 264.8 m<sup>2</sup>, të cilën do t’ia japë në përdorim shoqërisë “MC Catering” sh.p.k.

- Ekstrakt i regjistrimit tregtar për subjektin I.Darsi
  - Ekstrakt i regjistrimit tregtar për shoqërinë “ MC Catering ” sh.p.k.
  - Akt miratimi higjieno sanitar datë 26.12.2017 për magazinë frigoriferike
  - Licencë e lëshuar nga QKB, për shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëzit)
  - Deklaratë e shoqërisë MC Catering sh.p.k. se magazina plotëson të gjitha standartet tekniko – teknologjike
  - Çertifikatë e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimet, e lëshuar në datën 15.04.2020, me nr. 2782 prot, nga Bashkia Kamëz
  - Foto
6. Dokumenti me emërtimin “ Leje drejtimi 4 punonjës ” në sistemin e prokurimeve elektronike, ku evidentohen lejet e drejtimit të katër punonjësve B.I., P.R., S. I., S.K.
7. Dokumenti me emërtimin “ Leje drejtimi 4 punonjës ” në sistemin e prokurimeve elektronike, ku evidentohen lejet e drejtimit të katër punonjësve A.N., E. A., V. N., M. M., shoqëruar me listëpagesën e muajit gusht të shoqërisë “ MC Catering ” sh.p.k. ku evidentohen emrat e lartpërmendur të katër personave për të cilët janë paraqitur lejet e drejtimit.

III.2.3. Sqarojmë se nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “ MC Catering ” sh.p.k., ashtu siç edhe autoriteti kontraktor sqaron në informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, rezulton se ky operator ekonomik ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar për dy mjetet e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.2.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet teknike, organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, nga verifikimi i kryer i dokumentacionit të operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k., konstatohet që, ky i fundit, plotëson kriterin e kërkuar në dokumentat e tenderit pasi ka paraqitur dokumentat në lidhje me mjetet e kërkuara në dokumentat e tenderit.

III.2.7. Për më tepër, sqarojmë se, në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për kriterin në lidhje me mjetet, duke shprehur thjesht “që automjetet e paraqitura shfaqen në QKR-në e operatorëve të tjerë ekonomik”, pra një pretendim në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotëson kriteret e vendosura në DST operatori ekonomik i kualifikuar në vend të parë, duke mos paraqitur asnjë fakt apo provë se ku i bazon pretendimet e tij të ngritura në ankesë.

III.2.8. Akoma më tej, referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetençës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përçaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:*

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.2.9. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.10. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.2.12. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me dy pretendimet e tjera të ngritura nga ankimuesi në ankesën e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe në atë të paraqitur pranë autoritetit kontraktor (ankesa e paraqitur në autoritet kontraktor e depozituar bashkëlidhur ankesës së dorëzuar pranë KPP-së), Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se :

III.3.1. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se bashkëlidhur është depozituar edhe formulari i ankesës së operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. i cili është protokolluar pranë autoritetit kontraktor. Në këtë formular ankese, ashtu siç rezulton edhe në kthimin e përgjigjes së ankesës së drejtuar operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se ai përmban dy pretendime të ndryshme nga ato të paraqitura në ankesën e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Konkretisht, në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik (e cila është e njëjtë edhe me ankesën e dorëzuar në autoritetin kontraktor dhe të cilën ankimuesi e ka depozituar bashkëlidhur ankesës së dorëzuar në KPP), dy pretendimet e tjera janë si më poshtë :

*3.Mendojmë se shoferët e paraqitur nuk figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik.*

*4.Mendojmë se nuk plotësohet periudha tre mujore e stafit prej katër personave të deklaruar.*

Ndërsa referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se në formularin e ofertës i cili është protokolluar pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, shihen se janë ngritur dy pretendime të ndryshme si më poshtë :

*3.Mendojmë se kodi i shoferave nuk përputhet me sigurimet shoqërore të operatorit ekonomik MC Catering”*

*4.Mendojmë se dokumentacioni i dorëzuar për pikën e shërbimeve të ngjashme nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e procedurës në fjalë.*

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, së pari, pretendimet e ngritura në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor dhe konkretisht pretendimi 3 dhe 4 (*3.Mendojmë se kodi i shoferave nuk përputhet me sigurimet shoqërore të operatorit ekonomik MC Catering”*

*4.Mendojmë se dokumentacioni i dorëzuar për pikën e shërbimeve të ngjashme nuk është në përputhje me natyrën dhe objektin e procedurës në fjalë*), referuar formularit të ankesës së paraqitur në informacionin dhe dokumentacionin e autoritetit kontraktor të depozituar pranë KPP-së, rezultojnë të jenë paraqitur vetëm në autoritet dhe nuk janë ngritur më pranë KPP-së në respekt të shkallëve të ankimimit të përcaktuara në nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik ”, i ndryshuar. Në këtë kuptim këto pretendime nuk mund të meren në shqyrtim përse kohë që nuk ekzistojnë më si të tilla përdërisa nuk janë ngritur edhe në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Së dyti, referuar pretendimeve të paraqitura në ankesën e depozituar pranë KPP-së (dhe që konstatohen edhe në ankesën e paraqitur prej ankimuesit si të depozituar pranë autoritetit kontraktor), konkretisht pretendimet 3 dhe 4 (*3.Mendojmë se shoferët e paraqitur nuk figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik.*

*4.Mendojmë se nuk plotësohet periudha tre mujore e stafit prej katër personave të deklaruar),*

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se sërish edhe për këtë rast nuk janë respektuar shkallët e ankimit në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartësisht se:

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

4. Nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor zgjat afatet kohore të procedurës së prokurimit për periudhën e pezullimit, të përmendur në pikën 3 të këtij neni. Në rast se afatet kohore të procedurës së prokurimit, të njoftuara për ofertuesit, ndryshojnë për shkak të shqyrtimit të ankesës, autoriteti kontraktor duhet të njoftojë të gjithë ofertuesit për arsyet e zgjatjes së afatit kohor. 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.

7. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor” Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme”.

III.1.2. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimimit, duhet të kishte ngritur këto pretendime pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik e më pas edhe në Komisionin e Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankesë pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimimit, nuk mund të shtohet apo ndryshohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Në këto kushte sa më sipër analizuar, pretendimet e mësipërme të ngritura nga operatori ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim për shkak të mosndjekjes së shkallëve të ankimimit në respekt të legjislacionit për prokurimin publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF- 65963-07-20-2020, me objekt për Lotin II “Blerje bulmet dhe nënprodukte të tij”, me fond limit 27.101.138 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 13.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara..
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1162 Protokolli**

**Datë 21.09.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**